

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dosja - Behajdin Allaqi: Çfarë dihet për zhdukjen e tij dhe çfarë konstatoi Gjykata Speciale
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918777/behajdin-allaqi-cfare-dihet-per-zhdukjen-e-tij-dhe-cfare-konstatoi-gjykata-speciale/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 22:19:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 22:08:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b45075ec912e92c93903d4eb10ade98003d628cede0ca86f342339f74e073041
TEKSTI	f8c7f295462b8d93de558395f3cb0ed351bb10be91f04352a4b8596fa341f946
PAMJA	8106461044cffff7f154d0c4bb922af856aa1beb711ea8e7137eb94bccd6c3efe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	af87cb4f0b9f47290957efbe413500d55b1be4ff66bea72f3eb3f384790a3d75
E MËPARSHMJA	ca91818e40f5af9aba9d0d0743d7a6e4393fdf51dd737d7f4ea6fbb64255e910
RRËNJA MERKLE	9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/af87cb4f0b9f47290957efbe413500d55b1be4ff66bea72f3eb3f384790a3d75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**LAJMI I FUNDIT****LIVE - Seancë plenare dhe protestë, policia 'blindon' parlamentin! Flet kreu i PD-së, Sali Berisha**

Social Media/ Albin Kurti (Public domain)

më të lexuaratVIDEO- 'Janë 3 orë përgjime'/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Protesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënMashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartëVIDEO- 'Hajde të tregoj unë ty'/
Përplasja me Ramën në avion, i riu: Më
kapi për qafe dhe më tha 'të zhduk'Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë

'S'ka normalitet për situatën ku

**Behajdin Allaqi: Çfarë dihet për zhdukjen e tij dhe çfarë konstatoi Gjykata Speciale**

00:08, 24/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Behajdin Allaqi, profesor nga Prizreni dhe veprimtar politik, u zhduk në qershor të vitit 1998. Rrethanat e zhdukjes së tij mbetën të pasqaruara për vite me radhë.

Më 16 shtator 2026, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, në aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, konstatuan se Allaqi ishte vrarë pasi Thaçi dhe Veseli e kishin marrë të prangosur nga shtabi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Drenoc të Rahovecit.

Mbrojtja e Thaçit, ish-president i Kosovës, e ka kundërshtuar mënyrën se si gjykata e ka trajtuar rastin, duke thënë se teksa përfundimet për vrasjen e Allaqit u bënë publike, provat mbetën konfidenciale.

Kush ishte Behajdin Allaqi?

Behajdin Allaqi u lind më 7 prill të vitit 1963 në Prizren.

Për jetën dhe veprën e Allaqit, familja e tij ishte rrëfyer te Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK), organizatë që merret me drejtësinë tranzicionale.

Sipas rrëfimit të familjes, ai kishte përfunduar Fakultetin Filozofik në Prishtinë, dhe ligjëronte sociologji e filozofi në Prizren, ndërsa ishte angazhuar vazhdimisht për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Allaqi ishte pjesë e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), dhe konsiderohet dëshmor i UÇK-së.

Në vitin 2015, presidentja e atëhershme e Kosovës, Atifete Jahjaga, e kishte dekoruar Allaqin si Hero të Kosovës.

Sipas ligjit në Kosovë, kjo dekoratë "u jepet personave që kanë bërë vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës".

Radio Evropa e Lirë u përpoq të kontaktonte pjesëtarë të familjes Allaqi për intervistë, por nuk mori përgjigje në asnjërin nga mesazhet e dërguara.

1993: "Mosmarrëveshja" me Thačin dhe Sylën

Sipas përmbledhjes së aktgjykimit të Dhomave të Specializuara, Allaqi kishte pasur në vitin 1993 një "mosmarrëveshje serioze me Thačin dhe Azem Sylën", të cilët e akuzuan atë se kishte sjellë në LPRK një person të cilin e dyshonin si spiun serb.

Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, para zhdukjes së tij në vitin 1998, Allaqi ishte nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së dhe se Thaçi dhe Veseli kishin kërkuar të njoftoheshin për praninë e tij në shtabin e UÇK-së në Drenoc.

11 qershor 1998: Allaqi shihet për herë të fundit

Sipas rrëfimit të bashkëshortes së tij, Nazmije Allaqi, në "Librin e Kujtimit të Kosovës 1998-2000", botim i Fondit për të Drejtën Humanitare që dokumenton personat e vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës, Allaqi ishte parë për herë të fundit më 11 qershor 1998 në Prizren.

Ajo kishte thënë se Behajdin Allaqi kishte shkuar në drejtim të Shtabit të UÇK-së në fshatin Drenoc të Rahovecit, dhe nga aty ishte nisur drejt Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që në atë kohë ishte në zonën e Drenicës.

Pas kësaj date, nuk ka të dhëna publike se Allaqi është parë i gjallë.

Çfarë konstatoi Gjykata Speciale?

Sipas përmbledhjes së aktgjykimit të 16 shtatorit 2026, Allaqi kishte shkuar në shtabin në Drenoc rreth 11 qershorit 1998. Trupi gjykues konstatoi se Thaçi dhe Veseli kishin mbërritur më vonë dhe e kishin marrë Allaqin të prangosur.

Allaqi nuk u pa më, ndërsa trupi gjykues arriti në përfundimin se ai ishte vrarë.

Në përmbledhjen e aktgjykimit nuk bëhen publike të gjitha provat mbi të cilat është mbështetur ky konstatim.

1 nëntor 1998: Komunikata e UÇK-së

Më 1 nëntor 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së publikoi Komunikatën Nr. 61, në të cilën thuhej se Behajdin Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Trupi gjykues i Dhomave të Specializuara e cilësoi këtë komunikatë si përpjekje për të fshehur atë që kishte ndodhur me Allaqin.

Sipas gjykatës, pas luftës Thaçi, Veseli dhe Azem Sylja u përpoqën gjithashtu ta bindnin familjen e Allaqit, përmes ryshfeteve dhe premtimeve, që të hiqte dorë nga kërkimi i drejtësisë. Gjykata tha se familja i kishte refuzuar këto oferta.

Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe mund të apelohej.

Të dhënat e dokumentuara pas luftës

Në fillim të viteve 2000, sipas një dokumenti të publikuar në media pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara, Nazmije Allaqi thuhet se kishte raportuar tek organet e UNMIK-ut se bashkëshorti i saj ishte "marrë nga policia serbe".

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, UNMIK-u nuk ka komentuar vërtetësinë e dokumentit, duke thënë se është i kufizuar në atë që mund të thotë, "duke pasur parasysh transferimin e kompetencave dhe të dosjeve" te autoritetet pasardhëse, ndërkombëtare e vendëse.

Nazmije Allaqi i kishte thënë hulumtuesve të Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK) se "Selim Krasniqi dhe Bedri Zyberaj kishin dijeni për rrëmbimin [e Allaqit]".

Radio Evropa e Lirë kontaktoi të Krasniqin e Zyberajn, që të dy ish-pjesëtarë të UÇK-së, në lidhje me rastin. Krasniqi tha shkurt se nuk ka njohuri, ndërsa Zyberaj publikimin e këtij artikulli, Radio Evropa e Lirë nuk ka arritur të marrë koment nga Zyberaj.

Rrëfimi në librin "Syri i Shqiponjës"

Syri i Shqiponjës

Duket qartë se likuidimi i tij është një akt i dyshimtë. Gjatë luftës ndodhin edhe gabime dhe kur ato vërtetohen, drejtuesit korrektë pranojnë edhe gabimin, duke kërkuar falje publike për të mos dëmtuar etikën e luftës në liri. Me vrasjen e Ramës, Rama jo!


ndodhemi', Këlliçi: Të gjithë e kanë pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama jo!

'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlorë Hysenin

'Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar', Blushi: 'KAYO' e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

Nata e 6 në shesh kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së/ Protestës i bashkohet edhe Përparim Rama

duhet më shumë guxim se për të shkuar në front!



Veprimtari Behajdin Allaçi as eshtrat nuk i dihen.

205

Libri "Syri i Shqiponjës" (Web Screenshot)

Rasti i Allaqit përmendet edhe në librin "Syri i Shqiponjës" të ish-pjesëtarit të UÇK-së, Ilaz Kadolli.

Në libër, zhdukja e Allaqit përshkruhet si "likuidim pa gjyq", për të cilin, sipas autorit, "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së mban përgjegjësi politike, morale dhe ligjore".

Libri i Kadollit u pranua si provë me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, sipas një vendimi të vitit 2025 të Dhomave të Specializuara.

Megjithatë, nga dokumentet publike nuk është e qartë nëse pjesa e librit që trajton rastin e Allaqit ishte ndër materialet mbi të cilat trupi gjyqësor u mbështet konkretisht për konstatimet e tij për vrasjen.

I pyetur nëse ishte ftuar të dëshmonte për rastin e Allaqit, Kadolli tha për Radion Evropa e Lirë se nuk kishte pranuar të dëshmonte "për shkak të gjendjes shëndetësore".

Kapitulli lidhur me zhdukjen e Behajdin Allaqit në librin "Syri i Shqiponjës" nga Ilaz Kadolli.

Çfarë thotë mbrojtja?

Avokati i Thaçit, Lluka Mishetiç, shkroi në platformën sociale X se trupi gjyqësor e kishte lidhur publikisht klientin e tij me vrasjen e Allaqit, edhe pse më parë kishte urdhëruar të gjitha palët të mos e diskutonin çështjen e Allaqit në seancë publike në gjykatë.

"Trupi gjyqësor e ka shpallur publikisht Thaçinin fajtor për një vrasje, duke i mbajtur njëkohësisht provat mbi të cilën e bazoi këtë përfundim larg shqyrtimit publik. Thaçi do ta mirëpriste një shqyrtim të tillë publik të provave", tha Mishetiç, më 17 shtator, një ditë pas aktgjykimit në Hagë.

Edhe avokati tjetër i Thaçit, Pierre-Richard Prosper, në një intervistë në televizionin Klan Kosova, kundërshtoi publikimin e përfundimeve pa informacionet që i mbështesin. Ai tha se mbrojtja kishte informacione dhe pyetje për rastin, por nuk ishte lejuar t'i diskutonte publikisht.

E pyetur nga Radio Evropa e Lirë në lidhje me rastin e Allaqit, Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë tha se "nuk do të komentojë materiale që nuk janë bërë publike".

A u hetua ndonjëherë në Kosovë zhdukja e Allaqit?

Pas luftës në Kosovë, në fillim të viteve 2000, UNMIK-u kishte kompetenca të plota ekzekutive dhe gjyqësore.

Ky mision nuk ka komentuar rastin e Allaqit, dhe nëse ka nisur hetime për të gjatë kohës sa ishte kompetent, përkatësisht deri në vitin 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë.

"Dosjet e mëparshme të UNMIK-ut lidhur me hetimet dhe ndjekjet penale për

çeshtje penale iu transferuan [misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë] EULEX-it në vitin 2008, dhe mund të jenë transferuar më pas te autoritetet kompetente të Kosovës. UNMIK-u nuk komenton raste individuale që janë objekt i procedurave gjyqësore para gjykatave të pavarura", thuhet në përgjigjen e UNMIK-ut për Radion Evropa e Lirë.

Në anën tjetër, as EULEX-i, që mori kompetencat pas UNMIK-ut, nuk komentoi nëse e ka trajtuar ndonjëherë rastin e Allaqit.


"Për shkak të përfundimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë në vitin 2018, rastet dhe dosjet e trajtuara nga EULEX-i iu dorëzuan autoriteteve të Kosovës", thuhet në përgjigjen e këtij misioni për Radion Evropa e Lirë.

As Prokuroria Speciale e Kosovës nuk është përgjigjur në atë se a ka pasur ndonjëherë hetime brenda sistemit ligjor të Kosovës në lidhje me rastin e Behajdin Allaqit, para se ai të trajtohej në Hagë. /REL

Syri i Shqipërisë

Duket qartë se likuidimi i tij është një akt i dyshimtë.

Gjatë luftës ndodhin edhe gabime dhe kur ato vërtetohen, drejtuesit korrektë pranojnë edhe gabimin, duke kërkuar falje publike për të mos dëmtuar etikën e luftës për liri. Me gjasë, për të pranuar gabimin sot duhet më shumë guxim se për të shkuar në front!



Veprimtarit Behajdin Allaqi as eshtrat nuk i dihen.

Likuidimi pa gjyq i Behajdin Allaqit

Ishte fundi i qershorit 1998, kur porsa kishim përfunduar një takim të Brigadës 123, në të cilin ishte analizuar gjendja në terrenin e veprimit. Në të dalë nga komanda takuam Muharrem Dinën- Mixhën. Rralleherë ai shihej i ngrysur e i shqetësuar aq shumë si atë ditë. I thamë të hynte brenda, por nuk pranoi. Shihej nga fytyra që kishte një shqetësim të thellë.

U larguam paksa nga hyrja e objektit të brigadës për të biseduar më lirshëm. Mixha tregoi në tërësi për rastin e Behajdin Allaqit. Më 12 qershor 1998 ai kishte dalë në luftën e UÇK-së. Atë ditë qershori, në shoqëri edhe me vëllanë e Mixhës, Rifat Dinën, ishin paraqitur në zonën e Rahavecit, përkatësisht në Shtabin e fshatit Drenaj. Me të mbërritur aty, Behajdinin ia kishin vënë prangat, me urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Nuk dihej me saktësi nëse një natë ishte mbajtur i lidhur në Drenaj, por dihet me siguri që Behajdinin i prangosur ishte dorëzuar në Shtabin e Përgjithshëm në Altar dhe që nga ai moment nuk dihet asgjë për fatin e tij. Nga dita e arrestimit kishin kaluar rreth njëzet ditë dhe Mixha dyshonte se Behajdinin mund ta kishin vrarë. Dvshimin për mundësinë e vrasjes së tij e përforconte

më tepër fakti se familja e të afermit e Behajdinit, menjëherë pas arrestimit ishin alarmuar e interesuar për fatin e tij në Shtabin e Drenajt, ku kishin marrë garanci se Behajdini ishte dërguar në Shtabin e Pergjithshëm të UÇK-së.

202

Libri "Syri i Shqiponjës" (Web Screenshot)

Syri i Shqiponjës

Ishte kohë lufte dhe ngjarjet mbulonin njëra-tjetrën, ndërsa rasti i zhdukjes pa gjurmë të Behajdinit sa vinte e rritej dhe bëhej misterioz.

Tani për fatin e tij interesoheshin edhe shumë veprimtarë të Lëvizjes në Tiranë e diasporë. Behajdini gjatë 10-vietëshit të fundit ishte ndër udhëheqësit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.